



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0321

OSHP: 2025/ 0328

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga UD Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Batisha Ibrahim – Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatoret Ekonomik OE “3PEZ” L.L.C. & “Primo Studio” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “093 Hartimi I projekteve të palestrave sportive – salla e sportit Kryshec”, me numër të prokurimit:635-24-8870-4-2-3 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Pejës, me datën 23.06.2025, mori këtë:

Vendim

I. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa Operatoreve Ekonomik “3PEZ” L.L.C. & “Primo Studio” SH.P.K. e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 02.05.2025 me numër protokolli (321/25&328/25) për aktivitetin e prokurimit me titull:“ 093 Hartimi I projekteve të palestrave sportive – salla e sportit Kryshec” me nr. të prokurimit:” 635-24-8870-4-2-3”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna e Pejës.

II. Anulohet, B58Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit sipas dispozitivit I të këtij vendimi, dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

III. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Pejës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Konkursin e Projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “093 Hartimi I projekteve të palestrave sportive – salla e sportit Kryshec” me numër të prokurimit: 635-24-8870-4-2-3. Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për punë.

Me 16.04.2024 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka anuluar aktivitetin e prokurimit pasi që nuk ka ofertues të përgjegjshëm.

Me 21.04.2025, OE “3PEZ” L.L.C. & “Primo Studio” SH.P.K. kanë parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 24.04.2025, Autoriteti Kontraktues ka publikuar një vendim përmes të cilit hedhen poshtë si të pa bazuara ankesat e të dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 02/05/2025, OEA “3PEZ” L.L.C. & “Primo Studio” SH.P.K. kanë parashtruar në OSHP ankesën me nr. 321/25 & 328/25.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, OSHP ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 321/25 dhe ankesa nr. 328/25 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “3PEZ” L.L.C. janë parashtruar si në vijim:

Më datë 16.04.2025, përmes platformës e-Prokurimi, jemi njoftuar për vendimin e anulimit të aktivitetit të prokurimit nga ana e Autoritetit Kontraktues (AK). Komentet e vlerësimit për projektin tonë kanë qenë: “Kriteri B nuk është trajtuar sipas detyrës projektuese.”

Pas këtij njoftimi, kemi kërkuar qasje në dokumentacionin dhe projektet e operatorëve ekonomikë (OE) pjesëmarrës në këtë aktivitet prokurimi. Qasja na është lejuar në projektet e OE-ve pjesëmarrës.

Më datë 21.04.2025, kemi parashtruar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së, duke argumentuar se të gjitha kriteret e pikës B janë trajtuar me seriozitetin më të lartë nga ana jonë si OE, duke plotësuar të gjitha kriteret e dhëna për projektimin ideor, sipas dokumentacionit të tenderit (DT) si dhe Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Më poshtë paraqesim pretendimet tona, të cilat gjenden edhe në kërkesën për rishqyrtim:

Pretendimi 1

Sipas Autoritetit Kontraktues dhe komisionit të vlerësimit të projekteve, jemi eliminuar me arsyetimin se “Kriteri B nuk është trajtuar sipas detyrës projektuese” (Shifra 0107). Ndërkohë, ne si OE pjesëmarrës në këtë aktivitet prokurimi, argumentojmë të kundërtën, duke ofruar dëshmi dhe argumente që tregojnë se kjo pikë është përmbushur në çdo kërkesë të përcaktuar në detyrën projektuese.

Ritheksojmë më poshtë pikat e Kriterit B sipas detyrës projektuese dhe DT-së:

B. Ndërtesa - Pjesa për staf dhe sportistë

- Hyrja me erëmbrojtës
- Holli
- Hapësira për administratë
- Garderoba dhe nyjet sanitare për femra (sportiste)
- Garderoba dhe nyjet sanitare për meshkuj (sportistë)
- Nyje sanitare për staf
- Depo për pajisje dhe elemente sportive
- Kthina teknike

Duke filluar nga pika e parë, hyrja me erëmbrojtës është trajtuar në secilën prej hyrjeve në palestër. Si dëshmi, gjeni të bashkëngjitura detaje nga planimetritë e dorëzuara (Foto 1 dhe Foto 2).

Pretendimi 2. Holli i kërkuar në detyrën projektuese është trajtuar për hyrjen e sportistëve dhe për hyrjen e spektatorëve, duke pasur kapacitet të mjaftueshëm për qarkullim të rrjedhshëm.

Pretendimi 3. Kërkesa për hapësirë administrate është përmbushur duke ofruar hapësirë për administratë, përfshirë edhe një hapësirë shtesë që shërben si dhomë takimesh. Kjo hapësirë ka hyrje të ndarë nga ajo e sportistëve dhe spektatorëve, duke ofruar siguri dhe funksionalitet të lartë.

Pretendimi 4. Kërkesat për “Garderobë dhe nyje sanitare për femra (sportiste)” dhe “Garderobë dhe nyje sanitare për meshkuj (sportistë)” janë trajtuar në pjesën e sipërme të planimetrisë së përdhësës, pranë hyrjes së sportistëve. Këto janë të paraqitura në planimetritë e dorëzuara dhe të theksuara.

Pretendimi 5. Kërkesa për “Nyje sanitare për staf” është trajtuar brenda hapësirës administrative, nën hyrjen e veçantë për punonjësit, si dhe në zonën afër sportistëve.

Pretendimi 6. Kërkesat për “Depo për pajisje dhe elemente sportive” dhe “Kthina teknike” janë përmbushur me hapësira të mjaftueshme për nevojat e objektit dhe sallës, duke ofruar qasje

direkte dhe të veçantë në hapësirat e jashtme për futjen e pajisjeve të nevojshme.

Sa i përket pretendimit të AK-së për “ofrimin e versionit të përmirësuar të projektit” me ndërresa, ky pohim nuk qëndron. Pjesët që janë interpretuar si ndërresa janë vetëm sqarime vizuale për lokacionet e kthinave, për të lehtësuar kuptimin e projektit. Faktikisht, nuk ka dallim mes projektit bazë dhe versionit të paraqitur si “i rishikuar”, siç dëshmohet edhe nga planimetritë e skanuara dhe të bashkëngjitura nga vetë AK-ja.

Sa i përket çështjes së zbulimit të identitetit, kemi vepruar në përputhje me ligjin. Ligji parasheh qartë se në rast të mosplotësimit të kushteve formale, kërkesat për rishqyrtim refuzohen si të paplota (Neni 108/A - paragrafët 4 dhe 5; dhe Neni 111 - paragrafi 1 i LPP-së).

Gjithashtu, identiteti nuk është zbuluar para përfundimit të vlerësimit, për më tepër ka pasur edhe rivlerësim nga juria për këtë aktivitet, gjë që dëshmon përputhjen me Nenin 80, paragrafi 2 të LPP-së.

Këto sqarime synojnë të jenë të qarta për anëtarët e jurisë profesionale dhe tregojnë se projekti ynë përmban të gjitha kërkesat dhe funksionet e përcaktuara, duke dëshmuar se Kriteri B është trajtuar në përpikmëri sipas detyrës projektuese.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Primo Studio” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Më datë 16.04.2025, Autoriteti Kontraktues (AK) ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik vendimin për anulimin e procedurës së lartcekur, duke dhënë disa sqarime për mangësitë në projektet e secilit Operator Ekonomik.

Ne si Operator Ekonomik kemi qenë të angazhuar në këtë projekt që nga fillimi dhe kemi ndjekur të gjitha fazat, duke bërë të qartë padrejtësinë e Komisionit Vlerësues ndaj nesh si OE dhe favorizimin e një OE-je tjetër, i përmendur edhe në ankesat paraprake.

Ne, si pjesëmarrës në konkursin e projektimit, vlerësojmë se njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit është një veprim joprofesional dhe një diskriminim i qartë, specifikisht ndaj nesh si OE, duke u përpjekur në çdo mënyrë që të përzgjidhet fitues një OE për të cilin kemi paraqitur ankesa të shumta. (Të gjitha janë të listuara kronologjikisht më sipër te “Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit”).

Një nga këto ankesa është paraqitur edhe në "Organin Shqyrtues të Prokurimit" (OSHP), e cila është vlerësuar nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së si plotësisht e bazuar.

Vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit, i arsyetuar me disa komente që përmendin “mangësi” në projektet tona, është i ekzagjeruar dhe tendencioz. Të gjitha pikat për të cilat Komisioni Vlerësues është thirrur, nuk mungojnë dhe janë pjesë e projektit, të detajizuara në nivelin e kërkuar nga detyra projektuese. Këto kërkesa, sipas nevojës, mund të plotësohen më tej në bazë të kërkesave më specifike të njërive kërkuuese, respektivisht të Autoritetit Kontraktues.

Pra, nuk bëhet fjalë për asnjë mangësi në projekt-propozimin tonë, siç ka aluduar Komisioni Vlerësues. Prandaj, vlerësojmë se anulimi i procedurës është një tendencë e qartë për të mos na shpallur fitues të këtij konkursi të projektimit — veçanërisht pas vendimit të fundit të Panelit Shqyrtues të OSHP-së, ku janë evidentuar mangësi të mëdha në projekt-propozimin e ofertuesit të “preferuar” nga Komisioni Vlerësues.

Zgjidhja e vetme për AK-në, për të mos shpallur fitues projektin tonë, ka qenë anulimi i aktivitetit të prokurimit. Prandaj, edhe një herë, theksojmë se gjatë gjithë këtij procesi, Komisioni Vlerësues, së bashku me palët tjera të përfshira në kuadër të Autoritetit Kontraktues, kanë diskriminuar Operatorët Ekonomikë dhe kanë kryer shkelje të rënda të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP).

Komentet e Komisionit Vlerësues dhe përgjigjet tona:

Komenti 1: Mungon koncepti Përgjigje: Të nderuar, ju lusim që para se të jepni komente të tilla, fillimisht të kontrolloni me kujdes projekt-propozimin, sepse koncepti nuk mungon. Ai gjendet në faqen e parë të projektit me emërtimin: *01 Koncepti.pdf*.

Komenti 2: Parteri - Organizimi dhe dizajni: Mungon hapësira për biçikleta Përgjigje: Në projekt është e ndarë hapësira për parking dhe janë të definuara qasjet në lokacion. Këto hapësira janë të mjaftueshme për parkimin e automjeteve të ndryshme, përfshirë biçikleta, motorë, etj.

Komenti 3: Ndërtesa - Mungon sanitaria për administratë (staf) Përgjigje: Sanitaria për administratën nuk mungon. Ajo është paraqitur te pjesa e administratës, respektivisht në bazën e përdhësës, dhe figuron në legjendë me nr. *06 WC*.

Përfundim:

Edhe një herë, ne si OE kërkojmë nga Komisioni Vlerësues të tregojë profesionalizëm dhe të mos diskriminojë Operatorë të tjerë në mënyrë që të favorizojë një OE të caktuar, i cili ka dorëzuar një projekt-propozim në nivel shumë të dobët. Duke pasur parasysh që OE në fjalë është vlerësuar me 100% të pikëve në dy vlerësimet paraprake, atëherë pse tani thuhet se ka mangësi në projekt? (Mangësi që ishin të qarta që nga fillimi.)

Ku është përgjegjësia profesionale e Komisionit Vlerësues kur bie në kundërshtim me vetë vlerësimet e mëparshme?

Kërkojmë nga ju që të tregoni profesionalizëm, të mos e anuloni aktivitetin e prokurimit dhe të bëni përzgjedhjen dhe poentimin e projekteve në mënyrë meritore, jo duke ndikuar nga interesa të përbashkëta.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 05.05.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 321/2025&328/2025, ndërsa me datë 18.05.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 321/2025&328/2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE 3PEZ” L.L.C. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/321 kanë vlerësuar si në vijim:

Operatori Ekonomik “3PEZ L.L.C.” ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Pejës për anulimin e procedurës së prokurimit me titull “Hartimi i projekteve të palestrave sportive – Salla e sportit Kryshec”. Në ankesën e dorëzuar, OE pretendon se vendimi për anulim është i pabazuar dhe joproporcional, duke theksuar se projekt-ideja e paraqitur është përgatitur në përputhje me detyrën projektuese dhe kriteret e dosjes së tenderit. OE vlerëson se procesverbali i jurisë përmban vlerësime subjektive dhe se pretendimet për mospërputhje me detyrën projektuese janë interpretuar në mënyrë të padrejtë. Po ashtu, OE thekson se nuk është respektuar parimi i trajtimit të barabartë të operatorëve dhe kërkon rishqyrtim të vendimit.

ANALIZA E EKSPERTIT TEKNIK

Eksperti shqyrtues dhe eksperti teknik kanë analizuar me kujdes pretendimet ankimore të ankuesit dhe veprimet e AK-së, duke paraqitur konstatimet dhe vlerësimet si më poshtë:

Përgjigje ndaj pretendimit ankimor 1:

Eksperti teknik sqaron se, lidhur me pretendimin nr. 1 të OE ankues, në kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, në seksionin “PËRMBAJTJA E OBLIGUESHME E HAPËSIRAVE”, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që ndërtesa të përfshijë, ndër të tjera, edhe:

- B. Ndërtesa – Pjesa për staf dhe sportistë
 - Hyrja me erëmbrojtës
 - Holli
 - Hapësira për administratë
 - Garderoba dhe nyjet sanitare për femra (sportiste)
 - Garderoba dhe nyjet sanitare për meshkuj (sportistë)
 - Nyje sanitare për staf
 - Depo për pajisje dhe elemente e rekuizita sportive
 - Kthina teknike

Në propozimin e ofertuesit me kodin 0107, kërkesa është përfshirë në projekt përmes hapësirës së emërtuar si “Depo” dhe hapësirës së emërtuar si “Kthina teknike”. Prandaj, pretendimi i OE ankues konsiderohet i bazuar.

PËRFUNDIM DHE ANALIZË E EKSPERTIT SHQYRTUES
Bazuar në përgjigjet e Ekspertit Teknik dhe në analizën ligjore të Ekspertit Shqyrtues, konstatohet se një pjesë e hapësirave funksionale të kërkuara në Dosjen e Tenderit janë të përfshira në projektin ideor të operatorit ekonomik ankues, ndërsa në disa raste mungojnë emërtimet përkatëse në dokumentacionin grafik dhe teknik. Këto përbëjnë mangësi të natyrës formale, dhe jo përmbajtësore, pasi hapësirat ekzistojnë dhe janë funksionale. Autoriteti Kontraktues, në vendimin e datës 22.04.2025, i ka trajtuar këto si mangësi përmbajtësore dhe ka refuzuar projektin në tërësi. Sipas vlerësimit teknik, një pjesë e kërkesave janë përmbushur, ndërsa disa mungesa lidhen vetëm me mosemërtim, të cilat nuk e cenojnë përmbajtjen funksionale të objektit. Duke qenë se procedura në fjalë është konkurs për projektim, ajo rregullohet nga neni 80 i Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe neni 55.26 i

Rregullores për Prokurimin Publik (RrPP), të cilat kërkojnë që juria të kryejë vlerësimin profesional dhe të paanshëm, mbi bazën e kriterëve të paracaktuara në dosjen e konkursit. *"Juria do t'i vlerësojë projektimet vetëm në bazë të pikëve dhe peshës së tyre, ashtu siç janë të specifikuara në dokumentacionin e tenderit"*. Në këtë kontekst, Eksperti Shqyrtues vlerëson se juria ka pasur mundësi që mangësitë formale t'i reflektojë në poentim proporcional dhe të arsyetuar, në vend që ato të shërbenin si bazë për propozimin e anulimit të procedurës. Lidhur me pretendimin se operatori ekonomik ka dorëzuar një version të përmirësuar të projektit në fazën e ankesës, vlerësohet se vetëm dokumentacioni zyrtar i dorëzuar brenda afatit ligjor duhet të merret për bazë, por prezantimi i materialeve sqaruese shpesh nuk përbën shkelje procedurale, për sa kohë nuk ka ndikuar në vendimmarrjen e jurisë. Sa i përket pretendimit për zbulimin e identitetit të operatorit ekonomik gjatë procesit të ankesës, Eksperti Shqyrtues thekson se ky veprim është në përputhje me nenin 111, paragrafi 1.1 të LPP-së, i cili kërkon që çdo ankesë të përmbajë *"emrin, adresën dhe informatat kontaktuese të parashtruesit të ankesës"*. Prandaj, zbulimi i identitetit në këtë fazë është i ligjshëm dhe i domosdoshëm për trajtimin e ankesës, dhe nuk përbën shkelje, për sa kohë që nuk ka prova se ky informacion ka ndikuar në vlerësimin teknik nga juria.

Lidhur me pretendimet e OE "Primo Studio" SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/328 kanë vlerësuar si në vijim:

Operatori Ekonomik me kodin 1201 ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të Komunës së Pejës për anulimin e aktivitetit të prokurimit "Hartimi i projekteve të palestrave sportive – salla e sportit Kryshec". OE pretendon se vendimi është i pabazuar, diskriminues dhe joprofesional, pasi projekt-propozimi i tyre i përmban të gjitha kërkesat e detyrës projektuese dhe se vlerësimi është bërë në mënyrë të njëanshme për të favorizuar një ofertues tjetër. OE thekson se komentet për mungesa në projekt janë të pavërteta dhe të ekzagjeruara, dhe kërkon shfuqizimin e vendimit për anulim dhe rivlerësim të drejtë dhe objektiv të projektit.

ANALIZA E EKSPERTIT TEKNIK: Eksperti shqyrtues dhe eksperti teknik kanë analizuar me kujdes pretendimet ankimore të ankuesit dhe veprimet e AK-së, duke paraqitur konstatimet dhe vlerësimet e tij si më poshtë:

Pretendimi ankimor 1: Operatori ekonomik me kodin 1201 kundërshton vërejtjen e Komisionit Vlerësues lidhur me mungesën e konceptit në projektin ideor të dorëzuar. Sipas OE, kjo vërejtje është e pabazuar, pasi koncepti është përfshirë në mënyrë të qartë në dokumentacionin e dorëzuar, konkretisht në faqen e parë të projektit me emërtimin "01 Koncepti.pdf". OE kërkon nga komisioni që të kontrollojë me kujdes projekt-propozimet përpara se të japë komente të tilla, duke theksuar se dokumenti i përmendur ka qenë pjesë përbërëse e dosjes së dorëzuar dhe se mungesa e tij nuk qëndron.

Përgjigje ndaj pretendimit ankimor 1: Eksperti Teknik sqaron se, lidhur me pretendimin nr. 1 të operatorit ekonomik ankues, në seksionin "PËRMBAJTJA E PROJEKTIT" të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që projekti ideor të përmbajë:

- Prezantimin dhe elaborimin e konceptit dhe idesë në format tekstual, tabelar dhe grafik.

Në propozimin e dorëzuar nga operatori me kodin 1210, kjo përmbajtje është prezantuar në formatin tekstual dhe grafik, mirëpo mungon prezantimi në formë tabelare, siç është kërkuar. Prandaj, pretendimi i operatorit ekonomik ankues konsiderohet pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 2: Operatori ekonomik me kodin 1210 kundërshton vërejtjen e Komisionit Vlerësues lidhur me mungesën e hapësirës për biçikleta në projektin ideor. Sipas OE, në projekt janë të ndara dhe të shënuara hapësirat e parkingut, të cilat janë të mjaftueshme për parkimin e automjeteve të ndryshme, përfshirë edhe biçikletat dhe motorët. OE thekson se qasjet në lokacion janë të përcaktuara dhe të qarta, dhe hapësira për biçikleta është e përfshirë brenda këtyre zonave të parkimit, ndaj komenti i dhënë nga juria është i pabazuar.

Përgjigje ndaj pretendimit ankimor 2: Eksperti Teknik sqaron se, lidhur me pretendimin nr. 2 të operatorit ekonomik ankues, në seksionin “PËRMBAJTJA E OBLIGUESHME E HAPËSIRAVE”, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që në organizimin dhe dizajnin e pjesës së parterit të përfshihen qasjet për:

- Këmbësorë
- Biçikleta dhe ngjashëm
- Automjete

Në propozimin e operatorit me kodin 1210, kjo kërkesë nuk është e prezantuar në vizatime, vizualizime, dhe nuk është e përshkruar as në përshkrimin teknik, as në ndonjë pjesë tjetër që shpjegon qasjet.

Prandaj, pretendimi i operatorit ekonomik ankues konsiderohet i pabazuar.

Pretendimi ankimor 3: Operatori ekonomik me kodin 1210 kundërshton vërejtjen e Komisionit Vlerësues lidhur me mungesën e nyjes sanitare për administratën. Sipas OE, kjo hapësirë nuk mungon, pasi është e përfshirë në pjesën e administratës, konkretisht në bazën e përdhësës, dhe figuron qartë në legendën e planit me nr. 06 WC. Për këtë arsye, OE konsideron se komenti i dhënë nuk është i saktë dhe kërkesa është përmbushur.

Përgjigje ndaj pretendimit ankimor 3: Eksperti Teknik sqaron se, lidhur me pretendimin nr. 3 të operatorit ekonomik ankues, në pjesën “PËRMBAJTJA E OBLIGUESHME E HAPËSIRAVE” të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që ndër të tjera, në ndërtesë të përfshihet edhe nyja sanitare për staf. Në propozimin e operatorit me kodin 1210, kjo hapësirë është e përfshirë në projekt dhe figuron me emërtimin “WC”, si nyje sanitare për administratën. Edhe në vendimin e AK-së të datës 22.04.2025, konstatohet prania e kësaj hapësire, mirëpo nuk është specifikuar qartë se cilat elemente mungojnë për ta konsideruar të paplotë. Prandaj, pretendimi i operatorit ekonomik ankues konsiderohet pjesërisht i bazuar.

PËRFUNDIM DHE ANALIZË E EKSPERTIT SHQYRTUES
Bazuar në përmbajtjen e ankesës së operatorit ekonomik me kodin 1210 dhe në analizën e pretendimeve nga Eksperti Teknik, Eksperti Shqyrtues konstaton si në vijim:

- Pretendimi 1 (koncepti): Projekti përmban përshkrimin e konceptit në formë tekstuale dhe grafike; mungon vetëm forma tabelare. Kjo përbën një mangësi formale, që nuk e cenon përmbajtjen funksionale të projektit.
- Pretendimi 2 (hapësira për biçikleta): Sipas ekspertit teknik, kjo kërkesë nuk është përfshirë në vizatime apo përshkrime teknike, dhe si e tillë pretendimi është i pabazuar. Megjithatë, mospërfshirja e sinjalizimit për biçikleta, në vetvete, nuk e pamundëson funksionin e objektit, dhe nga këndvështrimi shqyrtues, do të duhej të trajtohej përmes poentimit.

- Pretendimi 3 (nyja sanitare për staf): Hapësira është e përfshirë dhe figuron si “WC” në plan, çka nënkupton se mangësia e pretenduar nuk është e plotë, ndërkohë që AK nuk ka dhënë sqarim të mjaftueshëm përse e konsideron të papërbushur këtë kërkesë.

Në këtë kuptim, mangësitë e evidentuara në projekt janë të natyrës formalo-teknike dhe nuk e pamundësojnë realizimin e objektit. Për rrjedhojë, nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme për anulimin e tërë procedurës së prokurimit. Vendimi i Autoritetit Kontraktues për anulim, i marrë pa një reflektim të balancuar për secilin ofertues dhe pa arsyetim proporcional të mangësive, cenon parimet e nenit 7 të LPP-së për trajtim të barabartë dhe mosdiskriminim, dhe nuk përputhet me nenin 80 të LPP-së, që kërkon që juria të marrë vendime të dokumentuara dhe të arsyetuara. Po ashtu, neni 55.26 i Rregullores për Prokurimin Publik përcakton se "*Juria do ta organizojë procesin e vlerësimit në atë mënyrë që të sigurohet integriteti dhe paanësia e procedurës. Juria do t'i vlerësojë projektimet vetëm në bazë të kritereve të shënuara (pikët e peshës të shënuara në Dosjen e Konkursit të Projektimit)*". Kjo nënkupton se çdo mangësi duhet të reflektohet përmes sistemit të poentimit të paracaktuar, dhe nuk mund të shërbejë si bazë për anulim të përgjithshëm, për sa kohë nuk është mangësi thelbësor. Megjithatë AK, në përgjigjen ndaj ankesës, ka konsideruar se mangësitë përbëjnë mospërputhje të natyrës përmbajtësore, analiza teknike dhe ligjore tregon se ato janë kryesisht të karakterit formal dhe të trajtueshme përmes poentimit, jo përjashtimit nga vlerësimi.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës të ekspertit shqyrtues/teknik për dy ankesat e pranuar përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e OE ankues; “3PEZ” L.L.C. & “Primo Studio” SH.P.K.

Pavarsisht se argumentimi në raportin e ekspertizës nga ekspertit shqyrtues/teknik është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit, pas përgjigjes nga AK -ja i cili nuk është pajtuar me raportet e ekspertizës pa ofruar ndonjë prove, Paneli Shqyrtues për qartësim të pretendimeve ankimore lidhur me këtë aktivitet për çka janë pranuar dy ankesa me datën 23.06.2025 ka ftuar seacë degjimore, ku perveq OE ankues 3PEZ” L.L.C, dhe ekspertit teknik ne seancë dëgjimore munguan OE “Primo Studio” SH.P.K, dhe Autoriteti Kontraktues per çka Paneli Shqyrtues i shqipton vërejtje ngase ne

momentin e fundit ka lajmruar qe smund të mer pjesë në seance, ndërsa ftesa për pjesmarje ka qen nga data 19.06.2025.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues mbështetur në nenin 1,7 të LPP-së lidhur me pretendimet e dy operatorëve ekonomik ankues (321/25&328/25) i ka falur besimin konstatimeve në raportin e ekspertit shqyrtues/teknik e te cilat mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorëve ekonomik ankues janë pjesërisht te bazuara dhe vendos ta anuloj B58 Njoftimin mbi vendimin e AK-se , kthen lëndën në Rivlersim , dhe kërkon nga AK-ja qe gjatë Rivlersimit ti përmbahet në tërsi të gjeturave në raportin e ekspertizes, si dhe të veproj në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 1 dhe 4 të LPP-së, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES, KOMUNA E PEJES**
- **OE - 3PEZ L.L.C., PRIMO STUDIO SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: